



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 22 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 2447 prot., datë 02.05.2024, referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Në vijim të çështjes së parashtruar në kërkesën tuaj mbi disa problematika të përfolura lidhur me organikat e disa institucioneve, keni kërkuar informacion mbi faktin nëse znj. {...} është e punësuar pranë institucionit tonë dhe nëse janë zbatuar për të dhe bashkëshortin e saj kushtet dhe kriteret e pastërtisë së figurës.

Për sa më sipër, ju informojmë se, bazuar në të dhënat që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk rezulton që znj. {...} të jetë e punësuar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për këtë arsye, Këshilli nuk ka informacion as mbi vendimin gjyqësor të referuar në kërkesën tuaj, sa i përket çështjes me të paditur z. {...}.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!